



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 30
20 korrik – 26 korrik 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	10 / 10	100%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	27 / 28	96%
		Librazhd	12 / 12	100%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	7 / 7	100%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	14 / 15	93%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%
		M. Madhe	6 / 6	100%

		Pukë	11 / 11	100%
		Kukës	13 / 14	93%
		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	9 / 9	100%
	Lezhë	Lezhë	10 / 10	100%
		Kurbin	5 / 5	100%
		Mirditë	5 / 6	83%
	VLORE	Vlorë	22 / 22	100%
		Sarandë	10 / 10	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
		Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	6 / 6	100%
		Gjirokastër	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	425 / 429	99%

Tabela 2. Numri total i rasteve të sindromave të survejancës “Alert” në javën 30

	JAVA 30
Diarre pa gjak	3301
Diarre me gjak	0
Infeksione respiratore të sipërme	5164
Infeksione respiratore të poshtme	1728
Rash me temperaturë	15
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i njësive raportuese	425
% e njësive raportuese	99% (425/429)



Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:

Tiranë – 10 raste


Vlorë – 1 raste

Fier – 4 raste


Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve.**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grup-moshave.**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet rritje në javën 30 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 29.

Grafiku 3. Trendi në kohë i “diarreve pa gjak” sipas javëve.




Grafiku 4. Shpërndarja e “diarreve pa gjak” sipas grup-moshave




Prirja në kohë e “diarreve pa gjak” paraqet rritje në javën 30 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 9.

Grafiku 5. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 20 – 30 të vitit 2025 dhe vitit 2026. Numri i rasteve.




Në javën 30 të vitit 2026 vërehet një rritje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.


Grafiku 6. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000).



Grafiku 7. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 29/2026 dhe 30/ 2026. Incidenca (raste/10.000).




Vërehet një rritje e lehtë e infeksioneve respiratore në disa NJVKSH, ndërsa aktiviteti i gripit mbetet në nivel të ulët sezonal.

Grafiku 8. Prirja e “Diarreve pa gjak” në javët 20-30 të vitit 2025 dhe 2026. Numri i rasteve.

Në javën 29 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i lartë i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 9. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 29-30 2026 Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Vlorë dhe Sarandë, ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga strukturat përkatëse të shëndetit publik. Kjo rritje vlerësohet se mund të lidhet me faktorët sezonalë dhe me lëvizjet më të shpeshta të popullsisë gjatë sezonit veror, periudhë gjatë së cilës rritet fluksi i pushuesve dhe frekuentimi i zonave bregdetare.

Gjithashtu, rritja e evidentuar mund të ndikohet edhe nga raportimi më aktiv i qendrave verore në sistem, të cilat gjatë kësaj periudhe raportojnë më shumë raste për shkak të shtimit të numrit të personave që kërkojnë shërbim shëndetësor. Situata mbetet në ndjekje të vazhdueshme për të vlerësuar dinamikën e rasteve dhe për të identifikuar në kohë çdo sinjal të mundshëm për grumbullim rastesh apo shpërthim epidemik.

Ngjarje ndërkombëtare

Shpërthimi i sëmundjes Ebola nga virusi Bundibugyo – Republika Demokratike e Kongos dhe Uganda (2026)

- Deri më 23 korrik 2026, Republika Demokratike e Kongos (RDK) ka raportuar gjithsej 2 905 raste të konfirmuara dhe 1 269 vdekje të konfirmuara të lidhura me sëmundjen (bazuar në të dhënat deri më 22 korrik). Kjo përfaqëson një rritje prej 97 rastesh të reja të konfirmuara dhe 62 vdekjesh që nga dita e mëparshme. Që nga fillimi i shpërthimit, janë prekur pesë provinca: Ituri, North Kivu, South Kivu, Tshopo dhe Haut-Uele.
- Në Ugandë, nuk janë raportuar raste të reja që nga 21 qershori 2026. Vendi ka raportuar gjithsej 20 raste të konfirmuara, përfshirë dy vdekje. Më 16 korrik 2026, Ministria e Shëndetësisë e Ugandës njoftoi fillimin e numërimit 42-ditor drejt deklaratimit të përfundimit të shpërthimit.
- Bazuar në informacionin e disponueshëm dhe duke marrë parasysh pasiguritë që lidhen me këtë shpërthim, probabiliteti i infektimit për personat nga BE/EEA që jetojnë ose udhëtojnë në zonat e prekura vlerësohet të jetë i ulët. Duke pasur parasysh probabilitetin shumë të ulët të importimit të infeksionit dhe transmetimit sekondar, probabiliteti i infektimit për personat që jetojnë në Bashkimin Evropian/Zonën Ekonomike Evropiane (BE/EEA) vlerësohet të jetë shumë i ulët. Ky vlerësim do të rishikohet me marrjen e informacioneve të mëtejshme.
- ECDC po monitoron shpërthimin përmes aktiviteteve të inteligjencës epidemiologjike dhe po bashkëpunon në mënyrë aktive me partnerët për të mbështetur përgjigjen ndaj shpërthimit.

Mbikëqyrja sezonale e Etheve Dengue në BE/EEA

- Që nga fillimi i vitit 2026 dhe deri më 22 korrik 2026, një vend në Evropë ka raportuar 1 rast të Etheve Dengue të fituara lokalisht: Franca (një rast). Gjatë kësaj jave, në ECDC është raportuar një rast i ri i etheve dengue.

Mbikëqyrja sezonale e etheve hemorragjike Krime-Kongo

- Që nga fillimi i vitit 2026 dhe deri më 22 korrik 2026, një vend në Evropë ka raportuar raste të etheve hemorragjike Krime-Kongo (CCHF) të fituara lokalisht: Spanja (dy raste).

Mbikëqyrja sezonale e infeksioneve nga virusi i Nilit Perëndimor

- Që nga fillimi i sezonit të transmetimit të vitit 2026 dhe deri më 22 korrik, janë identifikuar 35 zona të prekura nga virusi i Nilit Perëndimor (WNV) në gjashtë vende të Evropës. Këto zona ndodhen në Itali (20), Greqi (gjashtë), Rumani (katër), Maqedoninë e Veriut (dy), Spanjë (dy) dhe Francë (një).

World Pride – Holandë

- Që nga fillimi i periudhës së monitorimit më 20 korrik dhe deri më 23 korrik, nuk janë evidentuar ngjarje relevante të lidhura me sëmundjet infektive në kuadër të World Pride 2026.
- World Pride 2026 do të zhvillohet në Amsterdam, Holandë, nga 25 korriku deri më 8 gusht 2026. Pritet që aktiviteti të tërheqë një numër të madh pjesëmarrësish, përfshirë vizitorë ndërkombëtarë nga vende të ndryshme të BE/EEA.

- Probabiliteti i marrjes së një infeksioni seksualisht të transmetueshëm (IST) ose të infeksioneve të tjera që mund të transmetohen përmes kontaktit seksual është i rritur te personat që marrin pjesë në World Pride 2026 dhe kryejnë marrëdhënie seksuale me partnerë jo të qëndrueshëm dhe me partnerë të shumtë, veçanërisht në rastet kur masat parandaluese nuk zbatohen në mënyrë të vazhdueshme.

Malaria e lidhur me aeroportin në Gjermani

- Është raportuar një grup prej katër rastesh të malaries të shkaktuar nga *Plasmodium falciparum* të persona që kanë punuar në Aeroportin Ndërkombëtar të Frankfurtit përpara shfaqjes së simptomave, të cilat janë shfaqur ndërmjet datave 4 dhe 6 korrikut 2026. Asnjë nga rastet nuk ka raportuar udhëtime në zona endemike për malarien. Tre raste janë diagnostikuar në Gjermani dhe një rast në një vend tjetër të BE/EEA.
- Ngjarja është në përputhje me malarien e lidhur me aeroportin, e shkaktuar me shumë gjasë nga pickimi i mushkonjave të infektuara të gjinisë *Anopheles*, të introduktuara përmes trafikut ajror ndërkombëtar.
- Hetimet e shëndetit publik janë në vijim dhe përfshijnë identifikimin e mundshëm të rasteve të tjera të ngjashme, komunikimin e riskut, monitorimin e vektorëve dhe analizat gjenomike.
- Klinikët duhet të marrin në konsideratë malarien e lidhur me aeroportin në diagnozën diferenciale të rasteve me temperaturë të pashpjegueshme te personat me ekspozim të përshtatshëm në aeroport, edhe në mungesë të udhëtimeve të fundit në zona endemike për malarien.